



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1346 Prot.

Durrës më, 30/ 8 /2023

V E N D I M

Nr. 44 Datë 30/ 8 2023

"Për miratimin e tarifës së programit të studimit të përbashkët (Diplomë e dyfishtë) në ciklin e tretë të studimeve Doktoratë në "Shkenca Edukimi" në Fakultetin e Edukimit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës me Universitetin Pedagogjik Krakov Poloni"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.879, datë 16.02.2019 "Për disa ndryshime në VKM Nr. 41 "Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë" të ndryshuar, në Udhëzimin Nr.01, datë 14.01.2020, "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" të ndryshuar, të Senatit Akademik nr.38, datë 07.07.2023 , Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e tarifës së programit të studimit të përbashkët (Diplomë e dyfishtë) në ciklin e tretë të studimeve Doktoratë në "Shkenca Edukimi" pranë Departamentit të Pedagogjisë në Fakultetin e Edukimit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës me Universitetin Pedagogjik Krakov Poloni, sipas tabelës nr.1 bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore Fakulteti i Edukimit
 - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë
 - Drejtoria e Administrimit Financiar

Kryetar i Bordit të Administrimit

Ada ALIAJ

